



MEMORANDUM
I MIRËKUPTIMIT DHE I BASHKËPUNIMIT

Në mes të:

Autoritetit Kosovar të Konkurrencës “AKK”, me seli në Rr. Migjeni Pn, Kati VI, ish ndërtesa e bankës së Lubjanës, Prishtinë; e përfaqësuar nga z. **Valon PRESTRESHI** - Kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë “AKK”)

Dhe

Odës së Afarizmit të Kosovës “OAK”, me seli në Rr. Pashko Vasa nr.59, 10 000 Prishtinë, me numër të regjistrimit: 5116462-8, e përfaqësuar nga z. **Skender KRASNIQI** – Kryetar i Bordit (në tekstin e mëtejmë “OAK”)

Nënshkruajnë këtë **Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi**:

- I. Për të koordinuar aktivitete të përbashkëta për sa i përket konkurrencës në Kosovë e që ndërlidhet me qëllimet kryesore të të dy palëve.
- II. Për shkëmbimin e përvojave dhe për të siguruar qasje sistematike ndaj problemeve të identikuara gjatë punës së përbashkët.
- III. AKK dhe OAK pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe të ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social.
- IV. AKK dhe OAK pajtohen që të këmbejnë informacione nga bazat e veta të të dhënave lidhur me aktivitetet e tyre për aq sa nuk e cenon konfidencialitetin e çështjes. Këmbimi i shënimeve duhet të bëhet në bazë të kërkesave të autorizuara të të dy palëve duke

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCIU THE KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr. Prot./Br. Prot./Prot. No. <u>250/H7-02/10</u>
Nr. Fq./Br. St./No Pg. <u>1/2</u>
Data/Date/Date: <u>16.10.2017</u>
PRIŠTINA - PRISTINA - PRISTINA



respektuar fshehtësinë afariste e përcaktuar në ligj ose rregullore. Palët në marrëveshje janë të detyruar të ruajn fshehtësinë afariste nëse informata paraqet fshehtësi afariste.

- V. AKK dhe OAK pajtohen që në përgatiqen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përkrahjen e komunitetit të biznesit kosovar, të paradesin studimet e përbashkëta dhe të këmbejnë informatat e domosdoshme për implementimin e projekteve.
- VI. AKK dhe OAK si ofrues të përbashkët të këtyre shërbimeve dhe nxitës për një ambient më të mirë ekonomik, pajtohen se do t'iu ofrojnë partneritet konstruktiv institucioneve qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, në avancimin dhe ngritjen e standardeve drejt integrimit ekonomik të vendit me Bashkimin Evropian.
- VII. Ky memorandum i Mirëkuptimit dhe i Bashkëpunimit hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe do të ketë afat të pakufizuar, përderisa njëra palë me shkrim nuk e njofton palën tjetër 6 muaj më parë, për ndryshimet eventuale.
- VIII. Ky Memorandum i Mirëkuptimit dhe i Bashkëpunimit nënshkruhet në dy kopje për secilën palë nga një kopje.

Prishtinë, 16 Tetor 2017

Valon PRESTRESHI

Kryetar i AKK-së

2

Skender KRASNIQI

Kryetar i Bordit të OAK